BESA – BESË



ANTOLOGJIA E MARRËDHËNIEVE SHQIPTARO-HEBRAIKE NË NJË CIKËL AKTIVITETESH TË ORGANIZUARA NGA MAL BERISHA NË POSTE DHE DETYRA TË NDRYSHME SHTETËRORE DHE PRIVATE

"Në periudhën më të errët të historisë njerëzore, kur mizoria mbretëronte nëpër Evropë, populli shqiptar – i udhëhequr nga kodi i shenjtë i *Besës* – hapi dyert dhe zemrat e tij. Myslimanë e të krishterë, ata rrezikuan gjithçka për të mbrojtur fqinjët dhe të panjohurit hebrenj, jo për shpërblim, as për lavdi, por sepse ishte gjëja e drejtë. Me këtë akt, ata shpëtuan jo vetëm jetë, por edhe nderin e njerëzimit."

Mal Berisha

Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut

"In the darkest chapter of human history, when cruelty reigned across Europe, the people of Albania—guided by the sacred code of *Besa*—opened their doors and their hearts. Muslim and Christian alike, they risked everything to protect their Jewish neighbors and strangers, not for reward, not for glory, but because it was right. In doing so, they preserved not only lives but also the honor of humanity."

Mal Berisha

Knight of the Order of Skanderbeg

IN MEMORIAM

Profesor T. Scarlett Epstein ndërroi jetë me datën 27 Prill 2014, në moshën 92-vjeçare duke lënë pas kujtime shumë të vyera ndër të cilat nga më interesantet ato për Shqipërinë.



E njoha atë në ditët e para të punës time në Londër, kur kolegia ime diplomate, zonja Teuta Starova më njoftoi se Prof. Epstein dëshironte të më takonte dhe të njihej me mua. Kështu ndodhi. Ajo ishte një zonjë hebreje austriake e lindur dhe e rritur në Vjenë deri në moshën 16- vjeçe dhe e shpëtuar në Shqipëri ne vitet 1938 – 1939. I prirur për të ditur sa më shumë rreth historisë së hebrejve, e prita me shumë kënaqësi. Me pas, me Prof. Epsteinin na lidhi një miqësi e fortë.

Ajo ishte një zonjë shumë e dashur për Shqipërinë dhe shqiptarët. Me modestinë e njeriut të madh ajo më “mori për dore” në një udhëtim rrëfimtar të një jete që vërtetë impresionon çdokend që ka sado pak ndjesi njerëzore dhe dëshirë për të njohur e mësuar.

Ajo kishte një karrierë të gjatë akademike dhe kërkimore si ekonomiste dhe antropologe, autore e 14 librave, shume artikujve dhe filmave dokumentarë.

Ajo ishte nderuar me shumë çmime e tituj mes të cilëve titulli OBE (Urdhëri i Perandorisë Britanike) akorduar në vitin 2004.

Takimi i fundit me të në Shkurt 2014 në Shtëpinë e Pleqve në Brighton mbetet i paharruar

“Të notosh kundër rrjedhës”

Një ditë ajo më dhuroi një libër që kishte botuar rreth jetës së vet me titull:“Të notosh kundër rrjedhës”. Ky libër gjendet në bibliotekën time, dhe mban një përkushtim të shkruar me dorë nga autorja:

“Shenjë e vogël e një admirimi të madh” Scarlett.”

Rrëfimi i saj në atë libër të le pa frymë pothuajse në çdo faqe të tij. Dhe unë mendova se bazuar në atë rrëfim të sinqertë e dramatik të Profesor Epsteinit të bëja të njohur historinë e saj që është e lidhur me ne shqiptarët, pikërisht në këtë ditë kur ajo u nda nga jeta. Ky libër i botuar në gjuhën angleze në vitin 2005 në Londër përmban historinë e një jete të vështirë dhe përcjell një mesazh të fortë:

”Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare”!

Prof. T. Scarlett Epstein jetoi 92 vjet. Krejt e thinjur, timide, trupvogël ajo banonte në qytetin bregdetar Brighton të Britanisë së Madhe. Ajo gjëndej përherë e pranishme mes nesh sa herë që bëheshin veprimtari të Ambasadës Shqiptare në Londër. Atë e gjeje aty ku flitej për Shqipërinë, aty ku tregohej historia e hebrejve dhe Hollokaustit dhe mbrojtja që atyre iu kanë bërë shqiptarët në ditët më të vështira të historisë së tyre. E gjeje në shkolla, në universitete, në biblioteka, festivale filmi, takime të rëndësishme ndërkombëtare apo sinagoga. E gjeje në Uashington DC apo Nju Jork në mes shqiptarëve, në Universitetin e Vjenës apo në Parlamentin Europian në Bruksel, në Kembrixh apo Oksford por edhe në Tiranë. Dhe kudo, ajo përcillte këtë mesazh: ”Unë jam gjallë falë bujarisë shqiptare”!

Historia e saj është një histori tejet e dhimbshme, si shumë të tilla për hebrejtë, por me një fund të lumtur. Ajo ngjet me historinë e thuajse tremijë hebrejve që shpëtuan në Shqipëri.

Anschluss – Vjenë – Zagreb

Prof. T. Scarlett Epstein, ishte lindur në korrik të vitit 1922 me emrin Trude Grünwald. Ajo bashkë me prindërit dhe vëllezërit e saj u vu në shënjestër të nazistëve në atë periudhë të njohur si Anschluss ose aneksim i Austrisë prej Gjermanisë naziste i cili ndodhi me 12 Mars 1938,. Përndjekjet ndaj tyre ishin të përafërta me ato që zbatoheshin ndaj hebrejve në Gjermani. Kështu, si shumë familjeve të tjera, edhe familjes Epstein, tani më me emra të ndërruar, iu desh të linte Vjenën drejt një vendi më të sigurtë. Vajza e re 16 -vjeçare, e cila vazhdonte gjimnazin me plot endrra për të ardhmen, u ballafaqua me alternativën, jetë a vdekje. Kështu ajo e mori në dorë jo vetëm fatin e vet por edhe të prindërve të saj. Ajo arriti të siguronte viza hyrje në Jugosllavi dhe me ndihmën e xhaxhait që ishte një industrialist i madh, ata u vendosën në Zagreb. Por pas tre muajsh vizat e tyre skadonin dhe duhej të largoheshin nga Jugosllavia ose të dëboheshin me dhunë drejt vendit të origjinës. E vetmja rrugëdalje ishte të sigurohej ndonjë vizë për ndonjë vend jashtë influencës së gjermanëve. Ky vend doli të ishte Shqipëria.

Mbreti Zog dhe hebrejtë

Vajza e re troket në dyert e shumë konsullatave të cilat gjendeshin në atë kohë në Zagreb por të gjitha i mbyllen me forcë përpara syve sapo ajo tregonte pashaportën e saj me germën “J” të damkosur në të nga nazistët. Në këto rrethana, xhaxhai i saj i thotë se ka një shpëtim: është Shqipëria. Një hebre tjetër i cili bënte tregëti me Shqipërinë i kishte thënë atij se Shqipëria kishte një agjensi tregtare në Zagreb e cila kryente edhe veprime konsullore dhe i priste hebrejtë bujarisht. Sipas xhaxhait, Shqipëria festonte një përvjetor të saj dhe Mbreti Zog kishte dhënë urdhër që të jipeshin viza hyrje turistike, madje edhe për hebrejtë. Krejt çfarë dinte ajo vajzë nga mësimet e gjeografisë dhe historisë për Shqipërinë ishte se ishte një vend i cili shtrihej në vijën bregdetare të Adriatikut dhe kufizohej me Jugosllavinë dhe Greqinë. Tani familja hebraike

kishte tre zgjidhje: të fshihej nëpër Jugosllavi dhe të priste fatin e zi të dëbimit në Austri; të kthehej në Austri vetë dhe të përfundonte në ndonjë kamp përqëndrimi nazist, ose të shkonte në një vend të panjohur, në Shqipëri. Ajo arriti t'i bindte prindërit dhe vetëm tre ditë para skadimit të vizës trokiti në dyert e asaj zyre shqiptare. Konsulli shqiptar e priti atë me respekt dhe përkundër faktit që ajo i tregon se ishin hebre në kërkim me pashaporta me germën "J", ai i pajisi me viza. Ata menjëherë morën rrugën për në Split prej ku zunë një anije që do t'i zbarkonte në Durrës. Në nisje ata u përcillen prej shumë hebrejve të cilët ishin zënë në kurthin e tmerrit nazist. Me ata njerëz ajo nuk do të shihej më kurrë, pasi nuk i mbijetuan terrorit nazist.

Durrës – 20 Nëntor 1938.

Në këtë datë ata arrijnë në Durrës. Pasi zbarkojnë, priten nga dy hebrej gjermanë të cilët e kishin gjetur që më parë Shqipërinë si strehën e tyre mbrojtëse dhe jetonin në qytet. Ata i shoqërojnë dhe i vendosin në hotelin Metropol afër portit detar. Përshkrimi i saj rreth gjëndjes së këtij hoteli nuk lë vend për ndonjë kënaqësi por pritja e shqiptarëve ndaj kësaj familje në dëshpërim të plotë të bën të ndjehesh krenar. Ajo e përshkruan Durrësin e asaj kohe si një qytet me popullsi të përzier muslimane dhe ortodokse, që jetonin në paqe. Pas disa javësh qëndrim në hotelin Metropol, familjes i ofrohet mundësia të qëndronte në një një farë kompleksi i cili ishte dhënë nga bashkia. Aty gjendeshin hebrej me shtetësi të ndryshme të cilët tmerri nazist i kishte bashkuar në fatin e tyre. Ky kompleks banimi financohej nga Komiteti Ndërkombëtar Amerikan Hebraik i Ndihmave, natyrisht me pëlqimin e qeverisë së Mbretërisë Shqiptare.

Jeta në Durrës – Nëntor 1938 – 20 Prill 1939

Nevoja për të mbijetuar e mëson njeriun më shumë se gjithçka tjetër në jetë sepse vlera e jetës dyfishohet pikërisht atëherë kur ajo bëhet e pasigurtë. Kështu Scarlett Epstein fillon të kërkojë punë dhe arrin të gjejë nxënës që dëshironin të mësonin gjermanisht. Ndër to ishin dy vajza, bijat e familjes Dovana, një nga familjet më të njohura në Durrës. Me këtë familje ajo krijon një lidhje të fortë miqësore që ka vazhduar deri sot që ajo ka vdekur. Sipas ligjit

shqiptar, refugjatët nuk lejoheshin të punonin. Megjithatë ajo, falë miqësisë së mënjëherëshme që ndërton me shqiptarët ia del të bëhet mësuese edhe pse ishte ende aq re. Familja e saj trajtohet me një dashuri të veçantë jo vetëm nga banorët e thjeshtë të qytetit por edhe nga prefekti i Durrësit. Episodet e jetës së Scarlett Epstein në Durrës janë të gjitha aq piktoreske dhe interesante, por ajo çfarë mbetet në kujtesën e njeriut është se sa herë ajo i rrëfënte qoftë në audienca, qoftë në biseda private apo edhe në librin e saj, është dashuria që ajo përjetoi në atë qytet, për të cilën ishte aq mirënjohëse. "Shqipëria më shpëtoi jetën" ishte kryefjala e çdo rrëfimi të saj Megjithatë, ky nuk mund të ishte një vend me një të ardhme për hebrejtë e mësuar me tregti dhe profesione të tjera. Me dy vëllëzër në Britani, Oton dhe Kurtin ajo vendos të përpiqet të bashkojë familjen pikërisht atje. Kështu arrin të sigurojë viza për vete dhe nënën e saj, por jo dhe për babain. Vizat do të skadonin me datën 30 prill 1939. Ndërkohë ndodh ajo të cilën Epstein e përjeton dhe e përshkruan si një dëshmitare okulare me detajet e mëposhtme:

Dëshmitare e pushtimit fashist Italian – 7 prill 1939

Epstein tregon në librin e saj se mëngjezi i së premtës së mire, 7 prill 1939 u gdhi në Durrës bashkë me anijet që kishin filluar të dukeshin mizëri në brigjet e qytetit. Banorët e qendrës ku ishin strehuar refugjatët hebrej ishin udhëzuar të largoheshin dhe të hynin thellë në territorin e vendit pasi qendra e tyre ishte pranë policisë e cila kishte dy mitraloza. Ky do të ishte edhe objektivi kryesor i italianëve që do të thoshte se mund të dëmtonte seriozisht banorët e qendrës. Në qytet gjendeshin vetëm disa ushtarë të ushtrisë shqiptare. Hebrejtë vendosën të futeshin në qilarin e një shtëpie pranë komunës. Luftimet vazhdonin dhe ndjeheshin të shtënat. Hebrejtë prisnin çfarë do të ndodhte me ta dhe si do silleshin italianët?! Scarlett nuk e dinte nëse edhe italianët ishin anti-semitistë po aq sa ishin gjermanët. Hebrejtë vendosën të largoheshin duke marrë me vete vetëm gjërat me të lehta të mundshme. U larguan nëpër një fushë ku plumbat iu shkonin sipër kokës, për tu strehuar më pas në një shtëpi ku mundën të arrinin. Shkëmbimi i zjarrit midis forcave italiane dhe atyre shqiptare zgjati disa orë. Ajo dëshmon se kishte parë njerëz të vrarë dhe të mbetur në rrugë.

Përballë pushtuesit Italian – miku i armikut bëhet mik i hebrejve

Pas pak grupi i hebrejve u ballafaqua me italianët. Me bajonetat e armëve të hapura, ata iu dhanë udhër të ndalonin. Në krye të turmës ishte vajza Scarlett, jo vetëm për guximin, por edhe se ishte e vetmja qe fliste italisht. Ajo iu tha italianëve se ne jemi gjermanë. Italianët menjëherë iu kthyen atyre me dashamirësi duke iu thënë: "Gjermanët dhe italianët janë miq" pa e vënë re faktin që si hebrej që ishin, ata ishin armiqtë më të mëdhënj të Hitlerit i cili po i ndiqte këmba -këmbës. Ajo i shpjegoi komandantit italian se ata kishin dalë nga shtëpia nga frika e sulmit italian, por tani dëshironin të ktheheshin përsëri atje. Italiani i siguroi se meqë ishin gjermanë konsideroheshin miq ndaj do t'ju garantonin mbrojtje duke nderuar kështu marrdhëniet që ekzistonin midis dy vendeve. Kështu, sado që të duket si një shaka, ata u vunë nën kujdesin italian dhe u kthyen ne shtëpi, pa menduar se kë po mbronin ata realisht në këtë situatë. Me këtë premtim ata nuk po kuptonin nëse italianët ishin aty për ti mbrojtur apo për t'i ndëshkuar. Ajo e tregonte jo pa humor faktin që aleatët e Hitlerit, armikut më të madh të hebrejve, u bënë mbrojtës të tyre.

Pushtimi u krye të nesërmen e së Premtes së mirë dhe italianët vijuan drejt Tiranës. Hebrejtë mbetën në Durrës ndërsa Scarlett merr një letër nga prefekti i Durrësit, ish-konsulli italian që tashmë ishte bërë prefekt i pushtuesit. Ai i kërkonte asaj të vazhdonte t'i jepte mësim në gjuhën gjermane siç kishte bërë edhe më parë. Ai i premtonte se përsa kohë të ishte ai në atë detyrë asgjë nuk do të ndodhte me ta nga ushtria italiane. Vite më vonë ajo interesohet të mësoje për fatin e Luigi Aloisit pikërisht këtij konsulli që me veprën e tij kishte sfiduar jo pa rrezik racizmin fashist Italian.

Largimi nga Shqipëria

Kur rrjedhja e ngjarjeve mori drejtim tjetër, Scarlett Epsteinit nuk i mbetej gjë tjetër veçse të përdorte vizën angleze të cilën ia kishin siguruar vëllezërit. Kështu, me datën 20 prill 1939 ajo bashkë me nënën e saj, niset për një udhëtim tejet të rrezikshëm deri në Itali me anije e më pas me avion nëpër Berlin, Köln, Amsterdam, Londër. Vitet e mëtejshme të jetës së kësaj zonjë janë të mbushura plot e përplot me ngjarje, por historitë plot vuajtje dhe rrezik u

skalitën në kujtesën e saj duke memorizuar të shkuarën dhe duke ecur përpara udhëve plot të papritura të jetës. Megjithëse jetën si emigrante në Angli e fillon me sakrifica, duke qepur uniforma për ushtarët anglezë të Luftës së dytë Botërore, falë forcës e vullnetit të saj ajo arrin të vazhdojë studimet universitare, të bëjë doktoraturën e të bëhet profesoreshë dhe një ndër antropologet më të njohura në Britaninë e Madhe.

Miqësia me Profesor Scarlett Epstein

Me Prof. Epstein na lidhi një miqësi e fortë, e sinqertë dhe e bazuar në ndjenjat e bukura të mirënjohjes, mikëpritjes dhe Besës shqiptare. Ajo ka lënë dy vajza, Debby dhe Michelle, por në fakt edhe një tjetër, një zonjë shqiptare, ish Ministre Këshilltare e Ambasadës shqiptare në Londër, një pedagoge e nderuar dhe diplomate e shkëlqyer, Dr Teuta Starova që i ishte bërë vajza e saj e tretë. Ditë e netë të tëra, ajo i kalonte ose duke biseduar, lëvizur, shkuar nëpër universitete, sinagoga, shkolla për të folur për shqiptarët ose në telefonta të gjata duke bërë plane se si ta propogandonin vlerën shqiptare të Besës dhe mikpritjes në mjediset angleze.

Në vitin 2012 në Viener Library, në Londër u organizua një takim kushtuar Prof. Scarlett Epstein në prani të bashkësisë hebraike dhe shqiptare të Londrës. Atë veprimtari e nderoi edhe Ambasadori i Izraelit në Britaninë e Madhe, Sh.T. z. Daniel Taub. Aty ajo u nderua me simbolin e qytetit të Tiranës. Po ashtu kishte ardhur edhe zonja Ingrid Strati, një intelektuale e njohur shqiptare nga Durrësi, me qëndrim në Itali, pasardhëse e familjes së shquar patriote të Dovanave. Me atë familje Scarlett kishte rivendosur kontaktet vetëm pak kohë më parë me ndihmën e një tjetër diplomateje të Ambasadës shqiptare, zonjës Xhoana

Papakostandini, që fati kishte dashur që jo vetëm të ishte nga Durrësi por edhe që familja e saj të kishte miqësi me familjen Dovana. Dukej se edhe pas 74 vjetësh buka e Dovanajave nuk ishte harruar nga Epstein dhe as mirënjohja për ta dhe për Durrësin, nuk ishte shuar. Kështu, në pranverën e vitit 2012 ajo udhëtoi në Durrës, për të rishkelur përsëri mbi ato rrugë të memories ku pulsonin kujtime të vjetra dhe për të xhiruar një dokumentar mbi historinë e saj në atë qytet.

Po në vitin 2012, Scarlett Epstein udhëtoi për në Uashington DC për të marrë pjesë në përkujtimin e përpjekjeve të shqiptarëve për të mbrojtur hebrejtë gjatë Hollokaustit. Më pas, e ftuar nga Vatra festuam bashkë me të 100 -vjetorin e pavarësisë, të ftuar nga shqiptarët e Nju Jorkut. Në vitin 2014, pas një sërë aktivitetesh mbi Shqipërinë ajo mbajti një fjalim të gjatë në Parlamentin Europian për Besën shqiptare e cila u prit me një admirim të jashtëzakonshëm.

Epilog

Respekti për këtë zonjë është i pafund dhe rrjedh në të njëjtin shtrat kujtimesh, përpjekjesh, vështirësish që ravijëzuan tek ajo gruan e fortë, mirënjohëse përjetësisht ndaj shqiptarëve. Vërtetë që shqiptarët kanë bërë për këtë zonjë atë që bëjnë për çdo njeri që iu troket në derë por edhe ajo ua shpërbleu me aq shumë punë, për ta bërë të njohur këtë histori kudo, atje ku shqiptarët kanë nevojë për njohje, përkrahje dhe ngrohtësi. Pak kohë para se të vdiste i bëmë një viztë. Takimet e bisedat me të ishin jo vetëm të një kënaqësie të veçantë por edhe një detyrim moral ndaj një lidhje historike midis shqiptarëve dhe hebrejve, dy popuj që e kanë siguruar lirinë me aq mundime vuajtje e përpjekje.

Prof. T. Scarlett Epstein sapo është ndarë nga jeta dhe do të varroset me datën 29 Prill në varrezat hebraike në Hove, East Sussex, Brighton.Ajo la pas një histori, e cila nuk duhet harruar Edhe ky shkrim është një nderim ndaj çdo gjëje që Shqipëria bëri për të dhe atë që ajo bëri për Shqipërinë.

U prehtë në Paqë!

MB

DY FJALË PËR LIBRIN: “IZREALITËT NË SHQIPËRI” TË AUTORIT JOSEF JAKOEL

Nga Mal BERISHA

Ky libër doli në dritë njëherësh me njohjen reciproke që Republika e Kosovës dhe Shteti i Izraelit i bënë njëri tjetrit dhe vendosën mardhënje diplomatike. Ky është një ogur i mirë për të dy vendet mike.

Josef Jakoel, është emri i një izraeliti i cili sot për shumë njerëz mund të tingëllojë si një emër i "ri" dhe jo aq i njohur.

Por, për shumë të tjerë ai emër ka një kuptim të madh. Për bashkëkohësit e tij, ai ishte një pedagog dhe njeri euridit në Institutin Bujqësor në Tiranë, një teknicien dhe punëtor i palodhur në përhapjen e progresit në fushën e bujqësisë së vendit tonë, një zyrtar i Ministrisë së Bujqësisë. Po aq i njohur është ky emër edhe për shumë shqiptarë që i kanë njohur vajzat e tij Feliçitën dhe Ksenian, të cilat u lindën dhe jetuan në mesin e shqiptarve deri në vitin 1991. Për të bërë një hyrje sa më kuptimplote në këtë analizë të thjeshtë të këtij libri po e citoj vetë autorin e librit kur thotë:

"Jam krenar që në dejet e mia rrjedh gjaku i stërmunduar i Abrahamit, Isakut dhe Jakovit. Jam po aq krenar që u linda, u rrita, punova dhe u mplaka në gji të popullit shpirtmadh dhe fisnik shqiptar "

Emri i Josef Jakoel u shfaq në mediat amerikane fill pas rënjes së komunizmit. Në vitin 1992, Harvey Sarner, një filantrop i njohur hebre – amerikan, botoi një libër me titull: "Hebrejtë në Shqipëri". Libri bazohej në dokumente dhe shënime që autori i mori prej Josef Jakoel dhe të bijës, Feliçita Jakoel, në Israel.

Në vitin 1997, libri "Hebrejtë në Shqipëri" u ribotua me një titull tjetër, "Shpëtimi në Shqipëri – Një qint për qint e hebrejve të shpëtuar nga Hollokausti." Ai u plotësua me nga një parathënje prej Joseph DioGuradit, ish kongresmen dhe Presidenti Ligës Qytetare Shqipatoro Amerikane, kongresmenit Tom Lantosh dhe atij, Benjamin Gilman.

Ai libër, të cilin me autorizim të vetë Kongresmenit DioGuardi, kam patur nderin ta përkthej në gjuhën shqipe, ka në qendër emrin e Josef Jakoelit, një izraelit i Shqipërisë i cili kishte mbajtur një evidencë të plotë të pranisë fizike hebraike në Shqipëri. Autori, Harvey Sarner, i bën atij një dedikim shumë të ndjerë:

"Ky libër i kushtohet kujtimit të Josef Jakoel – Një Mose i shekullit të XX – të i cili iu priu bashkëatdhetarëve të tij drejt Tokës së Premtuar."

Ai përshkruan me emra dhe fakte se si dhe përse hebrejtë u shpëtuan nga shqiptarët gjatë periudhës më të errët të historisë së njerëzimit; Hollokaustit.

Deri në vitin 1990, përmendja e një historie të tillë ishte një tabu dhe mund të përbente rrezik për rrëfenjësit e saj.

Deri kur Josef Jakoel i dha ato evidenca dhe deri më sot kur është botuar libri në fjalë, thuajse të tërë autorët janë bazuar në dëshmi të dorës së dytë.

E drejta vonon por nuk harron.

Dhe ja më në fund, edhe pse pak me vonesë, lexuesit shqiptar i jepet në dorë një libër që tregon një histori sa interesante aq edhe tronditëse. Aty ka aq shumë ngjarje dhe emra, që dëshmojnë per shumë e shumë sakrifica në mbrojtje të një popullsie të lashtë, atë të hebrejve të papërkulur, por të rrezikuar nga çfarosja.

Ky libër në fakt, më shumë se çdo gjë tjetër është një kthim nderi që Josef Jakoel dhe të bijat i bëjnë popullit shqiptar. Dhe shqiptarët që i mbrojtën ata njerëz të mirë kanë të drejtë të thonë:

“Kush nderon tjetrin, nderon veten!

Për ta vënë në kontrast të plotë atë që kishte ngjarë në Shqipëri me izraelitët që jetonin këtu, me të tjerët që jetonin jashtë, madje edhe shumë afër nesh, në Korfuzin matanë detit, ai ia kushton librin:

“Motrës Eftihia, burrit të saj Rafo, djalit 5-vjeçar Niso, vajzës 2-vjeçare Lina, viktima të Hollokaustit: Nga Cefi.”

Ndërkohe ai me familjen e tij qëndruan në Shqipëri dhe kaluan të sigurtë pa iu hyrë ‘ferra në këmbë’ gjatë tërë kohës së Hollokaustit. Këtë kontrast ai e jep në një pasazh të librit kur thotë:

“Jeta në Shqipëri kalonte e qetë e krejtësisht normale, sikur ato që ndodhnin në Evropë i përkisnin një bote krejt tjetër, që nuk kishte asgjë të përbashkët me jetën e tyre”

Libri “Izraelitët në Shqipëri” i botuar me shumë sqimë nga Shtëpia Botuese “Çabej”, përbën një momument të rrallë të një dëshmie të pashoqe në historinë tonë më të re. Në fillim lexuesi do të njihet me një hyrje të shkruar nga Shirley

Cloyse DioGuardi, Këshilltare e Çështjeve Ballkanike në LQSHA në New York, si edhe përfshirjen e kongersmenëve amerikanë me origjinë hebraike, Tom Lantosh, Benjamin Gilman dhe Jerold Nadler. Më pas për biografinë e autorit Josef Jakoel, "Cefin", babain e saj të dashur, shkruan me shumë veneracion e bija, Feliçita. Ajo na jep një tablo të jetës në familjen izraelite të Jakoelëve dhe rolin që luante ai burrë mendjendritur, në edukimin e tyre sa me ndjenjat dhe virtytet e popullit të vet aq edhe me dashurinë për Shqipërinë, atdheun e tyre të dytë.

Vitet që nga koha e Hollokaustit kishin kaluar në heshtjen mbytëse të diktaturës, nga frika e persekutimit. Për hir të vërtetës, për Jakoelët kjo nuk vinte për shkak të origjinës etnike, pasi antisemitizmi në Shqipëri nuk ekzistonte, por për shkak se gjyshi Rafael Jakoel, ishte i shpronësuar. Dhe ja ku vjen një ditë dhe Feliçita, kjo bijë e Jakoelëve në vitin 1990, viziton Izraelin, shkon në Jeruzalem dhe sheh Muzeumin e Holokaustit dhe Kopshtin e "Fisnikëve midis Kombeve" Yad Vashem. Ajo mëson nga këto muzeume për tmerrin që kishte përjetuar kombi i saj prej Hollokaustit dhe e krahason atë me paqën dhe sigurinë që iu kishin dhënë shqiptarët hebrejve në atë kohë. Ajo mediton në atë vend dhe thotë:

"Brenda vetes u ndjeva krenare!"

Por, krenaria e saj *venitet* kur sheh se nga populli shqiptar i cili kishte demonstruar Fisnikërinë më të Madhe midis Kombeve të tërë Evropës, as që figuronte aty fare!? Dhe aty ajo i vë një detyrë vetvetes:

"Ta bëjë këtë Histori të Lavdishme të njohur në tërë botën."

Gjatë vizitës së saj të parë, ajo dorëzon tërë emrat e hebrejve të Shqipërisë, të mbledhur nga i ati Josefi. Falë punës së këtyre dy njerëzve, Yad Vashem, i cili në vitin 1990 kishte vetëm një emër shqiptar, atë të Refik Veselit nga Kruja, i vendosur në vitin 1987, sot ka të gdhendur plot 75 emra të "Fisnikëve Shqiptarë në mes të Kombeve". Jakoelët iniciuan edhe krijimin e Shoqatës Shqipëri – Izrael.

Josef Jakoel në këtë libër ka sjellë një evidencë të plotë ngjarjesh nga më të habitshmet sesi populli shqiptar i mbrojti izraelitët e vet, por edhe ata të huaj. Ai i jep përgjige edhe pyetjes se përse shqiptarët i mbrojtën hebrejtë? Përgjigjen e kësaj pyetje ai e gjen tek Kodi i lashtë i nderit të shqiptarit, tek Besa dhe Mikpritja dhe citon:

"Shpia e shqiptarit asht e Zotit dhe e Mikut"

"Po të hini miku në shpi, gjak me t'pasë do t'i thuash: Mirëseerdhe!"

Në një prezantim për Besën Shqiptare në Institutin e Kërkimeve Kebraike YIVO, në New York, një zonjë, nga salla, e cila kishte humbur tërë familjen nga Hollokausti më pyeti:

"Përse, përse e bëtë ju shqiptarët këtë, kur tërë Evropa e qytetëruar na vrau, na masakroi, na dorëzoi tek gjermanët, na dogjën në krematoriume, na zhdukën, na shkatërruan!?

Përgjigja ime ishte:

"Në Shqipëri nuk ekziston ligji i mos-kalimit të pragut të derës së oborrit ose "*trespassing*" siç i thonë amerikanët. Ekzison një ligj tjetër: Besa, Mikëpritja, Miku.

Një ndër gjerat e bukura që gjen njeriu në këtë libër është frymëzimi që ai sjell për ringjalljen dhe ruajtjen e gjuhës: Ai bën një paralele midis hebraishtes dhe shqipes kur thotë:

"Ringjallja e hebraishtes është një rast unik në historinë e filologjisë ku një "gjuhë e fjetur" ndër shekuj u shndrrua në një kohë të shkurtër në një gjuhë të gjallë dhe aktive" dhe shton:

"Kështu ndodhi edhe me gjuhën shqipe edhe ajo ishte varfëruar, e molepsur me huazime nga gjuhë të huaja që nuk iu bënte ballë kërkesave bashkëkohore. Punës i hyri Kristoforidhi dhe ajo punë vazhdon edhe sot."

Kur vjen fjala tek ngjarjet dhe faktet që paraqet vetë autori thotë:

“Ngjarjet në fjalë përmbajnë një dozë të tillë ndjenjash, lartësisht njerëzore, shpirtmadhësie, bujarie dhe guximi saqë duhet patjetër t’i bëhën të njohura botës. Faktet janë të vërteta, pa shtesa dhe zbukurime, pasi nuk kanë nevojë për to meqë flasin vetë”.

Në një rrëfim tronditës për motrën e vet në fund të librit ai tregon sesi vetë familja e tij jetonte me brengën e tmerrshme të dhimbjes për humbjen e tërë familjes së saj të dorëzuar tek nazistët që nga Korfuzi.

Ai shton:

“Çdo izraelit që jetonte në Shqipëri dhe që kishte pasë të afërm jashtë Shqipërisë, kishte të njejtën brengë pasi të tërëve iu ndodhi që të afërmit t’u ishin ekzekutuar”.

Pyetjes që shpesh bëhet nga të huajt sesa peshë kishte Shqipëria që mbrojti pesëqind, një mijë apo edhe dy tre mijë hebrej, kur në Evropë makina grirëse naziste eleminoi gjashtë milionë syresh, Josef Jakoel i përgjigjet tek citon Talmudin:

“Shpëtimi i një jete të vetme njerëzore është baras me shpëtimin e një bote të tërë”

Kur mëson për historitë e aq shumë hebrejve dhe shqiptarëve që i mbrojtën, mund të thuhet me plot gojën se, secila histori mund të përbëjë një libër shumë faqesh, më vete.

Në përfundim dua të jap një dëshmi krejt personale.

Kam patur fatin ta njoh nga afër Kongresmenin amerikan me origjinë hebraike, Benjamin Gilman. Lidhja e tij me LQSHA dhe kontributi i tij i jashtëzakonshëm ndaj çështjes së Kosovës ishte i lidhur aq sa me politikën amerikane aq edhe me ndjenjat e fuqishme që ai ushqente për popullin tonë. Kjo ishte e bazuar në këtë histori që Josef Jakoel i la trashëgim shqiptarëve, izraelitëve dhe mbarë botës. Neve duhet të punojmë që ta bëjmë këtë histori sa më të njohur. Personalisht kam patur fatin që ta prezantoj historinë e Shpëtimit të Hebrejve në Shqipëri lidhur edhe me jetën e Ambasadorit Amerikan Herman Bernstein

në Tiranë, në Ambasadën Shqiptare dhe atë Amerikane në Londër, në Sinagogën Pinner, në Kennedy School of Government në Harvard, në Akademitë Diplomatike në Vjenë, Gjenevë dhe Prishtinë, në Universitetin e Tiranës, Fondacionin "Ivanaj" si dhe në shumë institucione të tjera në Tiranë. Në fakt duke e bërë të njohur atë, ne shqiptarët e njohim edhe anën më të mirë të qenjes tonë.

Norman Greshman, fotogarfi i njohur hebre – amerikan, në Filmin "Besa – Premtimi" thotë:

"Shqiptarët nuk kanë aq shumë për të eksportuar, por ata kanë një produkt unik në botë:

BESËN SHQIPTARE"

Këtë produkt më mirë se kushdo e ka "përpunuar" për "treg" Josef Jakoel.

Ato çfarë përshkruhen në këtë libër përbëjnë një nga fenomenet më të bukura që na bën ne, shqiptarëve, krenarë përpara botës!

KURRË MË! NEVER AGAIN!

Nga MAL BERISHA

Sot është Dita Ndërkombëtare e Përkujtimit të Hollokaustit.

Dua ta përkujtoj këtë ditë me materialin bashkëlidhur – pasqyrë veprimtarishë në sallat më prestigjioze të Anglisë dhe ShBA – së:

- Asnjë jetë hebrejësh nuk e humbi në Shqipëri dhe në Kosovë, ndersa:
- 6 Milion hebrej u vranë në Evropë!

Çdo shqiptar duhet të përkulet me dhimbje për të rënët dhe me nderim përpara GINTILËVE SHQIPTAR që ushtruan BESËN SHQIPTARE dhe treguan fisnikërinë dhe dinjitetin tonë!

Proud to be Albanian!

PËRKUJTOHET DITA E HOLLOKAUSTIT NË UNIVERSITETIN MIDDLESEX

20 janar 2013: Mbahet një kumtesë me titull: ”BESA Shqiptare dhe Historia e Hebraizmit në Shqipëri” gjatë Ditës së Përkujtimit të Hollokaustit në Universitetin Middlesex. Kjo veprimtari u organizua nga Worshipful Mayor of Barnet, Councillor Brian Schama. Këshilltarë të zonës dhe pjesmarrës të rëndësishëm, diplomatë dhe antarë të bashkësive të ndryshme ndoqën veprimtarinë si dhe një procesion të mbajtur nga Hendon Town Hall deri në Middlesex University Quadrangle.

Tema e shërbimit përkujtimor ishte “Së bashku të ndertojmë një urë” i cili kërkonte dhe inkurajonte respekt për bashkësitë e ndryshme duke nderuar

viktimat e genocidit: bashkësi të tilla të cilat u shkatërruan nga Hollokausti nën përndjekjen naziste por edhe më vonë si ato në Kamboxhia, Bosnjë, Ruanda, Darfur, etj. Në këtë ditë përkujtimore foli shefi i Misionit të Shqipërisë i cili tregoi për mënyrën se si Shqipëria i mbrojti hebrejtë gjatë Hollokaustit, si ata vendas ashtu edhe të ardhurit nga vendet si Gjermania e Austria. Në fund të luftës Shqipëria ishte i vetmi vend në Europë i cili kishte më shumë hebrej së sa në fillim. Ai dha një pasqyrë të shkurtër por me plot fakte rreth mardhënieve midis dy popujve duke u ndalur tek gjurmët e hebraizmit që nga shekulli i V – të i erës së re me gjurmët e Sinagogës së Sarandës, Nathanailin e Gazës, Ambasadorin Bernstein etj. Shqipëria u cilësua vendi i 69 fisnikëve midis kombeve të gdhendur në Memorialin e Yad Vashemit.

MBRËMJE NË SINAGOGËN PINNER, LONDËR: PËRKUJTIM I TË RËNËVE TË GETOS SË VARSHAVËS

7 prill 2013: Ambasadori shqiptar në Mbretërinë e Bashkuar mori pjesë në natën përkujtimore të Yom Hashoah – të quajtur 'Një Mbrëmje Përkujtimore në Sinagogën Pinner' në rastin 70 vjetorit të Kryengritjes në Geton e Varshavës. Tema e mbrëmjes ishte "Resistance and Rescue". Folësi i parë i mbrëmjes ishte Ambasadori i Polonisë në Mbretërinë e Bashkuar Sh.T. z. Witold Sobkow dhe më pas fëmijët e të mbijeturave të Getos Polake, Janine Webber and Lili Stern-Pohlmann. Programi filloi me një ceremoni emocionale të ndezjes së qirinjëve

dhe një shërbesë fetare të shkurtër, të pasuar nga lexime prej të rinjve. Qiriri i dytë u ndez për Shqipërinë, Bullgarinë dhe Danimarkën, popuj që i mbrojtën hebrejtë në ditët e vështira të Hollokuastit. Zonja Gaby Glassman, Kryetare e Komitetit të Yom Hashoah në fjalën e saj tha:

"Dua të nderoj shumë shqiptarë të cilët bazuar në kodin e tyre të nderit BESA e cila kërkon që të huajit ti jipet strehë kur njeriu i panjohur është në nevojë dhe të trajtohet si mik".

Ajo falenderoi Ambasadorët e pranishëm, atë të Shqipërisë, të Gjermanisë, Polonisë, Hungarisë, Rumanisë, Sllovakisë, Austrisë dhe drejtorin e Qendrës së Institutit të Kulturës Polake.

”BESA – PREMTIMI” – FILM NË KINEMANË KILBURN LONDËR

18 nëntor 2013: Në kinemanë Triclycle Theatre Kilburn, Londër, u shfaq filmi “*Besa – The Promise”*, nje produksion amerikan i cili sjell përpara publikut hebraik të Londrës një histori të jashtëzakonshme të marrëdhënieve midis shqiptarëve dhe hebrejve gjatë përiudhës së Hollokaustit. Vështirë se mund të ketë një film i cili të jetë një krijim artistik dhe përsëri aktorë të jenë personazhet e vërtetë të ngjarjes; të jetë krijim artistik, por të mos ketë asnjë sajesë apo devijim nga e vërteta; të jetë dokumentar dhe të ruajë një natyrë krejt artistike;

të jetë një tregim i një ngjarjeje dhe tregimtarë të jenë vetë njerëzit e ngjarjes...Kjo është historia e Rexhep Hoxhës, babai i të cilit jo vetëm që ka strehuar familjen e Aronit, hebre nga Bullgaria, gjatë luftës por i ka lënë amanet të birit të përmbushë Besën që i ka dhënë mikut të tij hebraik: ti kthejë 3 librat e shenjtë të Torahut, libra të cilët ia besoi me shpresën se do të kthehej ti rimerrte kur lufta të mbaronte. Lufta mbaron. Shqipëria zhytet në izolim. Filmi është vlerësuar me çmime të larta. "Besa – Premtimi, -ashtu siç thotë në fund të filmit, fotografi Norman Greshman -"është eksporti më i mirë që shqiptarët kanë dhe që i nderon dhe i veçon ata nga çdo popull".

HISTORIA E PATREGUAR E SHPETIMTAREVE SHQIPTARE NË SINAGOGËN PINNER



16 Janar 2014: Në Pinner Sinagogë, në një nga zonat me numrin më të madh të banorëve hebrej në Londër, u organizua shfaqja e filmit dokumentar BESA me kontribut të veçantë të fotografit Norman Gershman. Më shumë se katërqind pjesmarrës, prej të cilëve edhe një numër i mirë shqiptarësh me banim në këtë qytet, ndoqën me vemëndje, respekt dhe emocion këtë veprimtari e cila u hap me fjalën e zonjës Gaby Glassman, Kryetare e Këshillit Organizativ të Sinagogës Pinner. Ajo nënvizoi fisnikërinë dhe virtytet e larta të shqiptarëve të cilat bënë që asnjë hebre në atë vend të mos dorëzohej tek nazistët. Më pas audience dëgjoi kujtimet e Prof Scarlet Epstein rreth përvojës së saj në Shqipëri.

PREZANTIM NË YIVO INSTITUTE OF JEWISH RESEARCH NË NEW YORK



14 Dhjetor 2014: Mal Berisha mbajti një prezantim në YIVO Institute of Jewish Research në New York City përpara një audience të gjerë ku të pranishëm ishin amerikanë, amerikanë- hebrej, shqiptaro -amerikanë, studjues dhe të interesuar për lidhjet e Shqiptarëve me hebraizmin. Ky prezantim dha një pamje

të gjërë të asaj se përse në Shqipëri gjatë kohërave më të vështira të Holokaustit por edhe në etapa të tjera nuk u dëmtua asnjë hebre.

QËNDRA HEBRAIKE JW3 PRET AMBASADORËT E SHQIPËRISË DHE KOSOVËS

25 janar 2015: Në Ditën Ndërkombëtare të Kujtesës së viktimave të Hollokaustit, Ambasadorët e Shqipërisë dhe të Kosovës morën pjesë në mbrëmjen e organizuar nga Qendra Hebraike JW3. Për këtë veprimtari u botua edhe një shkrim në Jerusalem Post. Modeli shqiptar i Besës që i mbrojti hebrejtë ishte tema e mbrëmjes.

LEKSION NË AMBASADËN AMERIKANE LONDËR – JETA E HERMAN BERNSTEIN

4 qershor 2015 : Java e kulturës shqiptaro-britanike, u mbyll me një aktivitet ku për herë të parë në historinë e Shqipërisë, brenda në Auditorin e Ambasadës Amerikës në Londër, u shpalos flamuri shqiptar si dhe një xhevahir i historisë së Shqipërisë i titulluar: “Jeta e Ambasadorit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës Herman Bernstein dhe Marrëdhëniet Shqiptaro – Hebraike si një model i tolerancës fetare”, mbajtur nga Ambasadori shqiptar në Londër. Ky

aktivitet u zhvillua me iniciativën e Ambasadorit Shqiptar, nën kujdesin e Ambasadorit Amerikan në Londer, Sh.T z. Matthew Barzun në bashkëpunim me Ambasadorin e Shtetit të Izraelit z. Daniel Taub dhe Abasadoren e Lituanisë zonjën Asta Skaisgiryte Liauskiene.

HISTORIA E MARDHËNJEVE MIDIS SHQIPTARËVE DHE HEBREJVE NË VEPRIMTARITË E AMBASADËS SHQIPTARE NË LONDËR DHE NË SHTYPIN HEBRAIK



Pinner Sinagoge – Londër:

Në mbrëmjen e 16 janarit 2014 në Pinner Sinagogë, një nga zonat me numrin më të madh të banorëve hebrej në Londër, u organizua shfaqja e filmit BESA – THE PROMISE – vepër e rregjisorit Jason Ëilliams me kontribut të veçantë të fotografit Norman Gershman.

Tanimë është bërë një traditë shumë e mirë që Ambasada Shqiptare në Londër në bashkëpunim me bashkësi të ndryshme hebraike të organizojnë veprimtari të ndryshme në nderim të veprës së shqiptarëve të cilët i mbrojtën jo vetëm

hebrejt vendas por edhe ata që erdhën në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Me datën 16 janar 2014, në Pinner Sinagogë më shumë se katërqind pjesmarrës, prej të cilëve edhe një numër i mirë shqiptarësh me banim në këtë qytet, ndoqën me vemëndje, kërshëri, respekt dhe emocion këtë veprimtari e cila u hap me fjalën e zonjës Gaby Glassman, e cila nënvizoi fisnikërinë shqiptare dhe virtytet e larta të shqiptarëve të cilat bënë që asnjë hebre në atë vend të mos dorëzohej tek nazistët.

Më pas ajo i dha fjalën ambasadorit të RSH në Mbretërinë e Bashkuar z. Mal Berisha. Në fjalën e tij ambasadori përshëndetëse u ndal tek mbrojtja që shqiptarët iu ofruan hebrejve dhe veçanërisht tek BESA Shqiptare, si vlera më e madhe morale e kombit shqiptar e cila qëndron mbi çdo fe.

Pas shfaqjes së filmit zonja Glassman, në emër të bashkësisë hebraike të Pinnër Sinagoge, i dorëzoi Ambasadorit shqiptar një çertefikatë në të cilën thuhej:

"Një pemë e mbjellur në Izrael për të shprehur mirënjohjen e jashtëzakonshme ndaj veprës trimërore të popullit shqiptar për strehimin dhe shpëtimin e refugjatëve hebrej nga Hollokausti"

ÇFARË ËSHTË ENTI BOTUES HEBRAIK – THE JC.COM – THE JEWISH COMMUNITY ONLINE?

Kjo revistë është krahu dixhital i Kronikës Hebraike (The Jewish Chronicle Ltd) e cila publikon Kronikat Hebraike, gazeta më e vjetër dhe më influencuese hebraike në botë.

E themeluar në vitin 1841, Kronika Hebraike – shpesh e njohur si JC nuk ka pronar as aksioner komercial dhe pavarësia editoriale e saj është e garantuar prej Trustit të Kronikës Hebraike. Ajo gjëndet në Londër me reporter në të gjithë botën. Lajmet e Kronikës Hebraike dhe faqet me opinione pasqyrojnë larminë

e gjërë të fesë hebraike, pikpamjet sociale dhe politike nga e majta tek e djathta, nga ortodoksia tek ato që nuk kanë të bëjnë me fenë.

Mbulimi i lajmeve shkon që nga hetimet e natyrës së fortë dhe me pasoja të mëdha deri tek raportimet e veprimtarive të bashkësive, me kontekst të siguruar prej komentatorëve dhe figurave kulturore. Gazeta e cila del çdo të enjte përfshin ngjarje të ndryshme, jetën dhe artin, sportin por edhe faqe të ushqimit dhe biznesit dhe botohet me kualitet të lartë dhe me ngjyra.

NJË ÇËSHTJE NDERI E SHQIPTARËVË QË MBROJTËN HEBREJTË.

Shkruar nga Jay Grenby, 3 shkurt, 2014

Roli i shqiptarëvë në shpëtimin e hebrejve nga nazistët u demonstrua përpara mëse 400 vetëve në një mbrëmje në Sinagogën Pinner prej ambasadorit të atij vendi, Mal Berisha.

Shqipëra ishte i vetmi vend i pushtuar në Europë i cili e mbylli periudhën e luftës me më shumë hebrej në fund sesa kishte në fillim, tha Z Mal Berisha. Vendi i tij ishte gjithashtu i vetmi vend europian në të cilin qoftë edhe një hebre i vetëm nuk u dorëzua tek nazistët ose humbi jetën për shkak të të qenit hebre. Hebrejtë u ushqyen, u strehuan, u fshehën në vende të sigurta, iu ofruan emra të dytë vendasish dhe dashuri familjare duke vënë veten në rrezik shumë të madh nga një popullsi që ishte më së shumti muslimane”

Heroizmi i tyre pasqyrohet tek BESA, kodi i tyre I nderit i ndjekur prej shqiptarëve pa marrë parasyshë përkatësinë fetare. Bazuar në parimin se “Shtëpia është e Zotit dhe e mikut”, i cili kërkon që shqiptari të jetë i gatshëm ta presë mikun me buke e krypë e zemër – dhe ta ruajë nderin e mikut të vet edhe nëse kjo e rrezikon vetë jetën e tij si mikpritës.

Këtu midis pjesmarrëve gjëndet një numër i madh djemsh e vajzash shqiptare që punojnë e jetojnë në këtë vend. Kjo mbrëmje përfshin edhe shfaqjen e një filmi dokumentar në të cilën do të shohim sesi hebrejtë dhe muslimanët japin dëshmi të dorës së parë të guximit moral dhe fizik të shqiptarëve si përpara ashtu edhe gjatë luftës.

“Sinagoga Pinner është e nderuar të njihet me heroizmin e jashtëzakonshëm që shkon përtej besimit fetar në këtë audience kaq të madhe dhe të larmishme, tha kryetarja e komitetit organizues”, zonja Gaby Glassman.

Ka qenë diçka tejet frymëzuese të dëgjonim shumë historira të mardhënjeve aq të mira midis muslimanëve dhe hebrejve edhe në momentet me të errëta të historisë.”

Ajo tha se bashkësia e zonës Pinner ka mbjellur një pemë në Lord Sacks Forest në Jerusalem, me motivacionin: “Në mirënjohje të thellë ndaj veprave të guximshme të popullit shqiptar i cili strehoi dhe shpëtoi refugjatët hebrej”.

Ajo i dhuroi ambasadorit një çertefikatë përkujtimore të kësaj ngjarje.

PINNER SHUL – NJË MBRËMJE PËR TË NDERUAR SHPËTIMIN E REFUGJATËVE HEBREJ PREJ SHQIPTARËVE GJATË HOLLOKAUSTIT

E Enjte 16 Janar 2014.

Shkruar nga Brian Eisenberg

Deri sa ra komunizmi në Shqipëri në vitin 1990, fakti shumë pak i njohur i rolit që shqiptarët kanë luajtur në shpetimin e hebrejve të persekutuar në Europë mbetej i pathënë.

Shqipëria ishte i vetmi vend i pushtuar ne Europë i cili në fund të luftës kishte më shumë hebrej se në fillim dhe është vertetuar se asnjë hebre i vetëm nuk është dorëzuar tek nazistët. Janë 69 emra shqiptarësh të gdhendur në pllakën perkujtimore në radhën e fisnikëve midis kombeve në Yad Vashem, Jeruzalem.

Gjatë më shumë se 18 vjetëve gjithnjë e më shumë është zbuluar historia e jashtëzakonëshme e një kombi të vogël. Kjo ishte edhe arësyeja e mbledhjes me datën 16 janar të mëse 400 vetëve në Sinagogën Pinner për të dëgjuar këtë histori të pathenë.

Ambasadori shqiptar, z. Mal Berisha bëri një prezantim të shkurtër të filmit “BESA – The Promise”. Ai foli rreth kodit të sjelljes së Shqiptarëve i cili bëri që hebrejtë të cilët po i iknin perndjekjes, ishin mirëpritur dhe mbrojtur madje edhe gjatë pushtimit nazist.

Filmi u shfaq për publikun për herë të dytë në Mbretërinë e Bashkuar (herën e parë gjatë festivalit të filmit hebraik në Londër) portretizon muslimanët të cilët i strehuan hebrejtë (duke rrezikuar jetën e tyre). Ai ndjek gjurmët e një familje hebraike për të përmbushur ‘Premtimin’ që i kishte dhënë babait të tij që një ditë t’i kthente një set special librash faljesh tek familja hebraike. Udhëtimi i tij

përfundon me sukses në Izrael ku djali i familjes së shpëtuar jeton, duke pas ndryshuar mbiemrin.

I prodhuar prej Jason Uilliams dhe drejtuar prej Rachel Goslins, filmit iu desh më shumë se 7 vjet që të përfundonte. Ai ve në pah se si shqiptarët që nga Mbreti Zog, politikanët, policët, njerëzit me përkatësi të ndryshme fetare, të tjerë të zakonshëm, gra dhe fëmijë, i ndejtën besnik kodit të tyre të nderit – Besës. Hebrejtë u strehuan, u ushqyen, u fshehën dhe iu afruan pseudenume – të tërë me rrezik për vetene tyre. Për shqiptarët që u përfshinë në këtë kod ishte thjesht "ajo cfarë secili duhet të bëjë"

Veprimtaria ishte pjesë e aktiviteteve të Harroë në kuadër të Ditës së Përkujtimit të Hollokaustit dhe u bë në Tu Bishvat, nën drejtimin e Gaby Glassman, Drejtuese e Mbrëmjes, Ajo i dhuroi Ambasadorit një certefikatë mirënjohje për vizitën e tij në Sinagogën Pinner dhe mbjelljen e një peme me motivin:

"Një pemë e mbjellur në Jeruzalem simbolizon mirënjohjen e jashtëzakonshme ndaj veprës trimërore të popullit shqiptar për strehimin dhe shpëtimin e refugjatëve hebrej nga Hollokausti".

1.-Ne kemi zbuluar se gjyshi i një antari të Sinagogës Pinner kishte shpëtuar sepse gruaja e tij, e cila ishte tanimë ne Britaninë e Madhe arriti të merrte një vizë nga konsullata shqiptare në Londër;

2.- Në kohën kur tregohet ky gjest i shqiptarëve, 70 % e shqiptarëve ishin muslimanë ndërsa pjesa tjetër katolikë dhe ortodoks;

3.- Norman Gershman, një fotograf i njohur hebraik-amerikan udhëtoi në Shqipëri me qëllim që të dokumentonte në terren ato që kishin bërë shqiptarët muslimanë për të shpëtuar hebrejtë, gjatë kohës së Holokaustit.

Ai dëgjon për Rexhep Hoxhën, një shqiptar musliman i cili përmbush premtimin e dhënë një familje hebreje nga i jati të cilët i kishte shpëtuar gjatë Hollokaustit për t'i kthyer librat hebrej të lënë amanet. Filmi tregon kërkimet e këtij njeriu deri në përmbushjen e premtimit

“Ambasadori ka investuar shumë energji për të promovuar historinë shqiptare në këto vite dhe prandaj ai e vlerësoi pa masë dhe në mënyrë të vecantë pjesmarrjen e një audience kaq të gjërë. Ai ishte gjithashtu me të vërtetë i lumtur që një pemë është mbjellur në emrin e tij.”

” Shkëlqyeshën! Ishte mrekulli! Ishte shumë emocionuese të shohësh kaq shumë njerëz tek marrin pjesë në këtë mbrëmje tek shihnin filmin. Ende jam nën pushtetin e këtyre ndenjave të fuqishme, të këtyre emocioneve”.

“Veprimtaria qe një sukses i jashtëzakonshëm dhe nësë qëllimi juaj ishte që më e pakta të siguroheshin sa më shumë njerëz që të dinë rreth besës dhe heroizmit shqiptar gjatë ditëve të errëta të Shoah, atherë mund të them se kësaj ia keni arritur.

Iu bëj thirrje që të ndaloni dhe të mendoni për një cast kur përmendet Shqipëria, si ajo ishte i vetmi vend në Europën e pushtuar me më shumë hebrej në fund të luftës sesa në fillim të saj.”

” Aspekti më i rëndësishëm është se nëpërmjet të përpjekjeve tuaja këto historira të pabesushme kanë filluar tani të bëhen gjithnjë e më shumë të njohura dhe se ky tregim i ri mund të krijojë një model të ndryshëm në mardhënjet tona.”



HERMAN BERNSTEIN AMBASADOR I SHBA – VE NË MBRETËRINË SHQIPTARE 1930 – 1933

Libër i ri i autorit Mal Berisha

Këto ditë, në Panairin e Librit në Tiranë, autori Mal Berisha u paraqit me librin e tij më të ri me titullin e mësipërm.

Në faqen e pasme të librit, autori shkruan:

“Herman Bernstein ishte një njeri universal i kohës së tij. Ai ishte një hebre – amerikan, pjesëtar i një populli të njohur për zgjuarsinë dhe idealet e larta, por i persekutuar dhe torturuar prej fanatizmit dhe shovinizmit të egër, në rrjedhë të historisë. I ballafaquar me përvojat më të hidhura të jetës, por edhe i rritur në qarqet më të larta intelektuale të kohës, ai u ushqye me parimet e lirisë dhe demokracisë amerikane. Heroi i këtij libri nuk ishte thjesht përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Mbretërinë Shqiptare, por edhe një mik i

vërtetë i shqiptarëve. Ai foli, shkroi, vizitoi vendet tona të bukura si mik i sinqertë, si mbështetës që e tregonte hapur simpatinë që ndjente për atdheun tonë. Bernstein kishte miqësi të ngushtë me Mbretin Zog, i cili më pas urdhëroi misionet konsullore shqiptare të lëshonin viza për hebrejtë në rrezik, duke e kthyer Shqipërinë e vogël në strehë të sigurtë e bujare për ta. Trashëgimia e kësaj vepre tepër humane i shërben edhe sot diplomacisë shqiptare. (Nga prezantimi i mbajtur në YIVO Institute of Jewish Resarch, New York, 14 Dhjetor 2014)

Ndërsa, në faqen e brendshme të xhaketës së librit, autori ka sjellë një ekstrakt të asaj cfarë Herman Bernstein thotë për mënyrën sesi ai i ka përvetësuar dijet gjatë jetës së tij:

"... I kam përvetësuar teoritë shkencore më moderne nga Metchnikoff. Kam diskutuar për fenë dhe për artin me Leon Tolstoin. Principet e filozofisë moderne i përfitova nga Henri Bergson, diplomacinë botërore dhe çështjet ruse nga Konti Witte dhe Maksim Kovalovski, teorinë e artit e mësova nga August Rodin, shtetformimin nga Theodore Roosevelt dhe Woodrow Wilson, mbrojtjen e të drejtave të grave nga Havelock Ellis, imperializmin gjerman nga Hans Delbrück, literaturën dhe pacifizmin nga Georg Brandes, politikën e luftës dhe të paqes së Vatikanit nga Papa Benedikti XV, Islamin nga Sheik – Ul – Islam, sionizmin nga Weizmann dhe Ajnshtajn, Revolucionin Rus nga Trocki, liberalizmin britanik nga Lordi Robert Cecil, historinë e Japonisë nga Marquis Okuma, dramën kontinentale nga Arthur Schnitzler dhe gjithçka tjetër nga George Bernard Shaw..."

Herman Bernstein

Ky është libri i radhës i cili shtohet në bibliotekën e autori pas botimeve të mëparshme:

"Shqiptarët, lisa mbi truallin ilir", "Shqiptarët, europianët më të lashtë dhe më të rinj", "Charles Telford Erickson, amerikani që i kushtoi jetën Shqipërisë", "Realitete shqiptaro – britanike".

Ai vazhdon të zhvillojë teorinë e Soft Power në dobi të njohjes së vlerave të kombit shqiptar nëpër botë pas ligjërimeve të tij në universitete e forume të rëndësishme si në Universitetin Harvard, Cambridge, Massachusetts, në Institutin e Kërkimeve Hebraike (YIVO) dhe Federatën Pan – Shqiptare “VATRA” në Nju Jork, në London School of Economics, në Ambasadën Amerikane në Londër dhe atë Britanike në Tiranë, së fundmi në Shkollën Diplomatike të Gjenevës në Zvicër.

A HOMAGE FOR THOSE KILLED IN AN ANTI-SEMITIST ATTACK IN PITTSBURGH, PENNSYLVANIA

The dreadful massacre that took place against the Jews, in a synagogue in Pittsburgh, Pennsylvania, where 11 Jews were killed, 6 others wounded, is a strong alarm bell for all mankind that opposes anti-Semitism. We Albanians are in the forefront of the world's noble men who defended Jews in their most difficult days of the Holocaust. Every activity that nourishes our national virtues of BESA, hospitality, compassion for those who are in need, and religious peace that do exist among us, is a contribution in this regard. Every human life is worthy. This is how the Albanian Righteous Among the Nations thought when they protected the Jews all in their account. We have to think today, in the same way as they did. It is true that there is no anti-Semitism in Albania, in Kosova, in Macedonia and in the Balkan territories populated by Albanians. However we must disseminate our history of relations with the Jews and make the world known with this noble Albanian story as it is not only a national obligation but a human duty, as well. This is a real contribution to the treasure of the best mankind's inheritance, which needs so much our Albanian example, even in such developed democratic countries like the United States and other countries where antisemitism is shown.

Never Again!

Proud to be Albanian!

NJË HOMAZH PËR HEBREJTË QË RANË NË SULMIN ANTI SEMITIST NË PITTSBURGH TË PËNSILVANISË

Masakra e tmerrshme kundër hebrenjve, në një sinagogë në Pittsburgh të Pensilvanisë, ku 11 hebrej u vranë dhe 6 të tjerë u plagosën, është një këmbanë alarmi e fortë për të gjithë njerëzimin që kundërshton antisemitizmin. Ne shqiptarët jemi në ballë të njerëzve fisnikë të botës që i mbrojtën hebrenjtë në ditët e tyre më të vështira të Hollokaustit. Çdo veprim që ushqen virtytet tona kombëtare si BESA, mikpritja, dhembshuria për ata që janë në nevojë si dhe paqen fetare që ekziston në mes nesh, është një kontribut në këtë drejtim. Çdo jetë njerëzore është e vyer. Kështu menduan Fisnikët Shqiptar midis Kombeve kur i mbrojtën hebrenjtë, duke marrë përsipër rrezikun edhe me jetën e tyre. Ne duhet të mendojmë sot, në të njëjtën mënyrë si ata. Është e vërtetë se nuk ekziston asnjë antisemitizëm në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoni dhe as në territoret ballkanike të populluara nga shqiptarët. Sidoqoftë ne duhet të shpërndajmë historinë tonë të marrëdhënieve me hebrenjtë dhe ta bëjmë botën të njohur me këtë histori fisnike shqiptare, pasi nuk është vetëm detyrim kombëtar, por edhe një detyrë njerëzore. Ky është një kontribut i vërtetë për thesarin e trashëgimisë më të mirë të njerëzimit, e cila ka aq shumë nevojë për shembullin tonë shqiptar, madje edhe në vende të zhvilluara demokratike si Shtetet e Bashkuara dhe vende tjera ku shfaqet antisemitizmi.

Kurrë më!

Proud to be Albanian!

SHPENDI TOPOLLAJ – MIKU I MADH I SHQIPTARËVE, DIPLOMATI I NDERSHËM DHE I DREJTË HERMAN BERNSTEIN

Rreth librit monografik të autorit Mal Berisha

E lexoja librin e diplomatit Mal Berisha për një tjetër diplomat, madje edhe të një tjetër kohe, Herman Bernstein, dhe më sillej nëpër mendje ajo shakaja e Henri Kizingerit, kur thosh se: “Më telefonoi ministri i Punëve të Jashtme të Amerikës Heig dhe më ngarkoi me misionin t`u shpjegoj politikën e jashtme të qeverisë sonë kinezëve, secilit më vete”. Natyrisht që ky nobelist që afroi politikisht vendin e tij me Kinën dhe Vietnamin e dinte më mirë se kushdo, se detyra e një diplomati, e ca më shumë ajo e një ambasadori, është nga më të vështirat dhe më seriozet.

Është njëkohësisht një detyrë që përveç ndershmërisë, kërkon edhe vlera të veçanta intelektuale dhe sidomos përkushtim. Duke i pasur këto cilësi si rrallë kush, brenda frakut të tij diplomatik, ish konsulli ynë i Përgjithshëm në Stamboll dhe më pas si ambasador në Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut dhe në Irlandë, Mal Berisha, në morinë e librave të tij mjaft të mirëpritur, kësaj here ka zgjedhur të trajtojë një figurë emblematike, por paradoksalisht, pak të njohur, si ajo e amerikano – hebreut Bernsteinit, i cili nga periudha 1930 deri në vitin 1933 kreu detyrën e ambasadorit të SH.B.A. – ës në Shqipërinë e mbretërimit të A. Zogut. Shekspiri diku ka thënë se: “Jeta është e shkurtër, por e vërteta rron shumë dhe arrin larg”.

Dhe ja tek e kemi kaq pranë dhe kaq të qelibartë (siç e thotë ky mbiemër), veprën e një miku të shquar si ky njeri, i cili kur u largua nga vendi ynë meritoi dekoratën më të lartë “Kordoni i Madh i Urdhrit të Skënderbeut” dhe cilësimin nga shtypi i kohës si “...një prej pionierëve të botës së re.” Është shumë domethënëse e vërteta historike se gati të gjithë vizitorët që kanë ardhur në

Shqipëri, jo vetëm janë mrekulluar nga bukuritë natyrore dhe mikpritja e popullit tonë tejet të varfër, por dhe janë dashuruar me Shqipërinë dhe janë bërë apologjetë të çështjes tonë kombëtare. Ne u detyrohemi shumë atyre. Dhe këtë bën edhe autori Mal Berisha me librin e tij, i cili nuk përqendrohet vetëm te vitet e protagonistit në Tiranë, por rrok gati gjithë veprimtarinë e tij si poet, prozator, publicist, përkthyes, gazetar, politikan, atdhetar e mik influent i shumë e shumë personaliteteve që ndikuan në historinë botërore, duke na e dhënë të plotë portetin e tij. Vetëm kështu mund të kuptohet sesa rëndësi i vinin vendit tonë, dhe sa respekt kishin për popullin tonë, presidentët e nderuar të Amerikës si Roosevelt, Wilson dhe Hoover, për të vazhduar deri në ditët tona. Janë disa momente që do të shërbejnë përjetësisht si gur themeli në miqësinë me SH.B.A. – në, si ajo deklarata e Presidentit Wilson në Konferencën e Paqes në Paris më 1919 – tën, për moslejimin e coptimit të vendit tonë, vendosja e marrëdhënieve diplomatike, ndihma për çeljen e shkollave emërmëdha, përkrahja e luftës nacional – çlirimtare, trajtimi mëse njerëzor i emigrantëve tanë në Amerikë, ndriçimi i mendjeve të shqiptarëve për rrezikun komunist, ardhja e zotit Bejker pas shembjes së diktaturës, më 23 qershor të vitit 1991, vizita e presidentit George W. Bush, pas të cilës u anëtarësuam në NATO, ndërhyrja ushtarake për çlirimin e Kosovës nga barbaria serbe e Millosheviçit etj. etj. Kur Bernsteini mbërriti në Shqipëri, situata ekonomike, politike e sociale ishte aspak e mirë. Por ai ishte i prirur ta gjente të mirën dhe të bukurën edhe duke parë nga dritarja e selisë së tij. E përshkruan atë me një romantizëm të ëmbël, e quan atë pamje magjepsëse dhe të çuditshme, tek e cila sheh një peizazh të jetës shqiptare me tërë format dhe ngjyrat e saj të larmishme. Ai ua përshkruan lexuesve amerikanë, që s`kanë asnjë dijeni për këtë vend e këta njerëz, me shumë ngrohtësi dhe me besim se shumë shpejt do të bëhet i zhvilluar si tërë popujt e qytetëruar të Evropës. Ai i fton ata ta vizitojnë këtë vend pa konflikte fetare, se po u vonuan, do humbasin shumë. Duhet ta njohin mikpritjen proverbiale dhe kostumet e bukura e të habitshme.

U thotë atyre që të shpejtojnë se shumë nga magjia e këtij vendi po zhduket, pasi po hyn e reja e jetës moderne. Dhe është po ky mik i yni që teksa kërkon nga qeveria e tij ndihmë për arsimin dhe bujqësinë tonë, me shumë dashuri i

drejtohet në një relacion presidentit të tij me këto fjalë: “Shqiptarët janë njerëz të tillë që më mirë vdesin, sesa të kërkojnë, më mirë mbarojnë në dëshpërimin e vet, sesa të qahen... Ata janë popull tragjik, por një racë heroike...” Dua të besoj se edhe vetë udhëheqësit shqiptarë, nuk mund të flisnin më me entuziazëm për popullin e tyre. Ky ambasador i njihte mirë dhe kurrë nuk i kapërcente detyrat e tij. Mal Berisha, ky shqiptar i kulluar, dhe me kulturë superiore, ka hulumtuar gjatë rreth kësaj figure kaq interesante dhe ka gjetur mjaft materiale nëpër arkiva që tregojnë se Herman Bernsteini ishte një mbrojtës i palëkundur i aspiratave tona për liri e pavarësi. Vlen të theksohet qëndrimi i tij ndaj çdo lloj synimi për ta pushtuar, shfrytëzuar apo për të përfituar nga mundësitë që Shqipëria kishte. Ai, mban qëndrim tepër të drejtë dhe demaskues, veçanërisht ndaj planeve djallëzore të Musolinit. Ai në tërësi, e shpall dyshimin e tij për tendencat aneksioniste të fashizmit dhe të Hitlerit, aventurat e të cilëve do ta çojnë botën në një luftë tjetër botërore. Mesa duket të çmendurit e Evropës, ende nuk kanë nxjerrë mësime nga kasaphana e Luftës së Parë Botërore. Edhe diplomatët italianë e ndjekin si hije çdo lëvizje dhe çdo qëndrim të tijin. Mali, na i ka dhënë në ligjeratë të drejtë, raportimet e tyre për këtë ambasador që ata e quajnë të shqiptarizuar dukshëm në çdo veprim të tijin. Madje, aq sa i gëzohen largimit të tij, aq edhe i tremben faktit se ai duke qenë me ato talente, pra me botime librash, artikujsh, novelash dhe mundësi politike, do të vazhdojë të përkrahë këtë vend dhe të mbështesë me këshillat e tij si shpëtimtar mbretin Zog. E për më tepër, sipas tyre, ky njeri që hapi shkollën teknike dhe atë të Golemit e Kavajës, ka mundësi të sjellë edhe ndihma të qenësishme ekonomike. Kapitull më vete në libër, autori i kushton marrëdhënieve të sinqerta dhe mjaft të përzemërta me vetë mbretin.

Për më tepër, ai nuk mjaftohet me vlerësimet dhe largpamësinë e këtij burri shteti, por edhe i kërkon dhe shkruan të parën biografi të tij. Sa baltë e helm është hedhur mbi figurën e A. Zogut nga komunistët. Por si ka mundësi që një burrë kaq inteligjent, një njohës i shkëlqyer i historisë, një diplomat me përvojë, një njeri i lirë në mendime, një njeri që nuk i kursen kritikat për askënd, flet për të me aq konsideratë? Mbi të gjitha, ai vëren një mprehtësi mjaft të hollë në vështrimin e problemeve si me fqinjët, ashtu edhe kur diskutohen farsa

ndërkombëtare. Është me mjaft domethënie vetëm analiza që A. Zogu i bën propozimit Briand për parandalimin e militarizimit dhe për pasojë edhe të vetë Luftës së Dytë Botërore. Ja si shprehet Zogu në bisedë me ambasadorin: “Unë kam vënë re se në këto konferenca problemet më të vështira janë ato që mbeten për t`u zgjidhur në mbledhjen e ardhshme e kështu me radhë dhe pastaj fillon akumulimi i problemeve dhe brengave më të vështira, të cilat nuk mund të zgjidhen dhe as të rregullohen, pasi vërtetë që aty nuk ka dëshira për t`i zgjidhur ato dhe për shkak se secili prej burrështetasve që shkojnë në ato konferenca është i përkushtuar t`i zgjidhë këto probleme sipas interesave të tij dhe jo nga pozicioni i mbarëvajtjes së përgjithshme.

Kjo është arsyeja përse unë mendoj se shtetet e Bashkuara të Evropës, siç i propozon Briandi, do të mbeten vetëm një ëndërr boshe, një gjest madhështor, i ndërmarrë me qëllim që Franca, kur të vijë ajo ditë, të realizojë përpjekjet e saj për të bashkuar Evropën, me qëllim që të sjellë paqen.” Asnjëherë H. Bernstein nuk harron të theksojë se shqiptarët janë pasardhës të Skënderbeut, dhe që edhe sot e kësaj dite ata vishen me të zeza për vdekjen e këtij heroi të papërsëritshëm. Ai thekson se për të, në vitin 1873 ka shkruar edhe vetë poeti amerikan, pedagogu i Harvardit Henri Uodsuërth Longfellou, dhe më vonë i ardhuri në Shqipëri më 1908 – tën Charles Telford Ericksoni i cili e niste kështu poemën e tij: “Ti dorën nuk e zgjate drejt skeptrit njollagjak, / As i trishtë nuk kërkove të shprishurën kurorë, / Përballë i dole që vetë të merrje hak, / Ndaj atij tirani djemrrëmbyes e idhnak, / Që dheun tënd kishte shtënë në dorë.” Mal Berisha vë në dukje se qëllimi i shkruarjes së këtij libri ka qenë të ndërthurrë tri shtete, pra tre popuj, që kupton veç atij shqiptar dhe amerikan edhe popullin hebre që aso kohe kishte mjaft probleme, pasi jo vetëm luftohej paturpësisht, por edhe bënte përpjekje të jashtëzakonshme për t`u organizuar si gjithë shtetet e popujt e tjerë të botës. Kjo populsi semitike me Abrahamin në krye, ishte vendosur në Palestinë tetëmbëdhjetë shekuj para lindjes së Krishtit dhe ende persekutohej e përndiqej. Kishte ardhur koha që vepra e Mojsiut për bashkimin dhe organizimin e tyre të përsëritej.



Herman Bernstein vërtetë ka lindur më 21 shtator të vitit 1876 në Vladislavov të Lituanisë dhe ka gjetur atdheun e tij të dytë qysh nga mosha gjashtë vjeçare në Amerikë, por e di mirë fatin e trishtë të popullit të tij, dhe bën çmos të japë ndihmesën e vet. Dhe ka të drejtë që ndihet krenar se është pasardhës i atij populli sa të zgjuar aq edhe trim. Lexoja pasazhet e këtij libri, kushtuar si mbrojtjes nga shqiptarët dhe qeveria e tij kur nazistët me shokë i terrorizonin, ashtu edhe veprës së Bernsteinit në favor të tyre dhe më kujtohej ajo që na sjell historiani Jozef, kur tregon për ngjarjen e Masadës. Konsulli romak Flaviusi në krye të 8 – 9.000 mijë ushtarëve e rrethon kështjellën në kodër ku ishin 960 banorë hebrej, nga të cilët vetëm 200 ishin ushtarë. Duke e ditur se ata do të luftonin deri në fund, romakët ngritën dheun gjashtëdhjetë metra me qëllim që të mundësonin përdorimin e dashit për të shpartalluan portën e kështjellës. Kur e panë se nuk kishin shpëtim, për të mos u turpëruar duke u dorëzuar, hebrejtë vendosën të vdisnin; ndaj dhjetë prej tyre i vranë ushtarët e shtrirë para grave dhe fëmijëve, pastaj si shtinë shortin, njëri vrau nëntë të tjerët dhe veten e tij. Thuhet se vetëm dy gra shpëtuan gjallë, duke ikur me gjithë fëmijë, nëpër kanalet e ujësjellësit poshtë pallatit, si për të treguar heroizmin që kishte ndodhur. Edhe ne shqiptarër duhet të ndihemi mirë për gjithë sa bëmë për ta, dhe që kjo vepër u njoh dhe u propagandua nga vetë Bernsteini. Siç e përmenda

më sipër, mendoj se ka qenë një zgjidhje mjaft e mirë që autori M. Berisha ka përfshirë diçka nga krijimtaria, intervistat dhe korrespondenca e Bernsteinit, pasi kjo e plotëson rëndesën që figura e tij kishte. Ndofta nuk është vendi të ndalemi posaçërisht në të, por duhet theksuar se ai qe një shkrimtar i mirëfilltë, që nuk e ndau detyrën si diplomat nga taleni letrar e gazetarsk, por duhet vënë në dukje se gjithçka ai shkroi që nga Ajnshtaini, Drajzeri, Weizmani, Cecili, Trocki, Papa Benedikti XV – të, Moisiu, Andrejevi, Rodeni, Ellisi, Bergsoni, Meçnikovi, Show, e deri te Leon Tolstoi, pa folur për të tjerë, më kujtojnë atë që dikush thosh për markezin e akuzuar si zhirondin Mari Zhan Antuan Kondorse: "Dashuria për njerëzimin gjallon dhe zbukuron çdo faqe të shkrimeve të tij". Dhe jam i lumtur që këtë e konstatoj edhe te diplomati dhe njeriu i mrekullueshëm dhe tepër i ditur, modesti Mal Berisha, që jep shembullin sesi duhen nderuar të gjithë ata që bënë sa mundën për Shqipërinë dhe shqiptarët.

THE TIMES OF ISRAEL

Following the International Holocaust Remembrance Day, a special event, co-sponsored by the Jewish Caucus, Israel Caucus, and European Club, featuring Mr. Mal Berisha, a distinguished Albanian ambassador of career, is going to bring the Albanian – Jewish History to the fore.

This event, open to the public, is entitled "A Promise and a People: The Albanian Jews and the Holocaust." It will be held on February 1, at 7 p.m. in the premises of Harvard Kennedy School (Starr Auditorium, Belfer Building, Second Floor, John F. Kennedy School of Government, 79 John F Kennedy St. Cambridge, MA 02138.)



Albania, the only Muslim-majority country in Europe, emerged from the atrocities of the Holocaust with a tenfold increase in its pre-war Jewish population. Based on the highest moral values of "BESA", the Code of Honor for Albanians, thousands of Jews were sheltered unconditionally by ordinary people, mostly in rural areas of the country, the announcement explains.

During this presentation, Mr. Mal Berisha, a writer and a seasoned diplomat (the last posting was an Ambassador of Albania to the United Kingdom), is expected to examine the political, cultural, and historical accounts through the eyes of a Jewish American Ambassador to Albania, the Monarch of Albania, and everyday Albanians who risked their lives to come to the help of fleeing Jews. Ambassador Berisha will offer remarks, followed by a moderated discussion and Q&A with journalist and public radio host, Christopher Lydon (Radio Open Source, WBUR).

"If there is a single Gentile nation that has the right to commemorate, being proud of its history of the time of Holocaust, that is the Albanian Nation. To remember that Day, I have the honor and privilege to hold this presentation, Mr. Mal Berisha said earlier this week via a posting to his official Facebook.

INSTITUTI YIVO PËR KËRKIME HEBRAIKE, NJË NGA INSTITUCIONET MË TË RËNDËSISHME NË BOTË PËR STUDIMIN DHE RUAJTJEN E HISTORISË, KULTURËS DHE GJUHËS HEBRAIKE, ME QENDËR NË NJU JORK.



In 2014, Berisha presented his first English book in Manhattan at the YIVO Institute of Jewish Studies in New York City and the US Embassy in London: “Herman Bernstein, US Ambassador to Albania” where he detailed the close relations between Jews, Albanians and the United States Government. The work of the U.S. Ambassador to Albania, Herman Bernstein (1930-1933), championed positive Albanian-Jewish relations.

This book raised a lot of interest but even more the fascinating spectrum he found to explore the relations between the Albanians and the Jews.

Ambasador Berisha, KCFO, has served as the Ambassador of the Republic of Albania to the United Kingdom of Great Britain and Northern Ireland and Ireland from 2012 to 2015. Previously Berisha served as General Consul of Albania to Istanbul from 1993-1997.

Berisha has graduated from the Academy of Arts of Albania. His life has been tightly linked with cultural anthropology in Albania. He is a history scholar and has published a number of books and articles about various subjects of history, culture and diplomacy.

Source: http://blogs.timesofisrael.com/mal-berisha-in-boston-a-promis

A MATTER OF HONOUR TO ALBANIANS WHO PROTECTED JEWS

By Jay Grenby, February 3, 2014

The role of Albanians in rescuing Jews from the Nazis was told to more than 400 people at a Pinner Synagogue HMD event by the country's UK ambassador, Mal Berisha.

Albania was the only occupied country in Europe to end the war with more Jews than at the beginning, Mr Berisha said. "It was also the only European country in which not a single Jew was handed over to the Nazis or lost his life. Jews were fed, sheltered, hidden in places of safety, offered aliases and family love at

great personal risk by their rescuers among a population that was largely Muslim."

Their heroism reflected "besa", a code of honour followed by Albanians irrespective of religion. Based on the principle that "the house of an Albanian belongs to God and the guest", it requires that citizens be ready to receive a guest with bread, salt and an open heart — and must defend their guest's honour even at risk to their own life.

A large contingent of young Albanians living and studying here were among the guests. The event also included the screening of a documentary in which Jews and Muslims give first-hand accounts of the moral and physical courage of Albanians, both before and during the war.

"Pinner Synagogue has been delighted to have been able to host this recognition of remarkable cross-religious heroism to such a diverse and large audience," said organising committee chair Gaby Glassman. "It was so uplifting to hear the many stories of positive Muslim and Jewish interaction, even at the darkest moments of history."

She announced that the Pinner community had planted a tree in the Lord Sacks Forest in Jerusalem "in grateful appreciation of the courageous acts of the Albanian people in rescuing and sheltering Jewish refugees", and presented the ambassador with a commemorative certificate.

IN MEMORIAM

Prologue

Professor T. Scarlett Epstein passed away on the 27th of April 2014 at the age of 92, leaving behind many precious memories, among the most interesting ones were those of Albania. I knew her in the early days of my work in London when my diplomatic colleague Ms.Teuta Starova informed me that Prof. Epstein wanted to meet me and get to know me. That's how it happened.

She was an Austrian Jewish lady born in Vienna and raised there until the age of 16. She resided in Albania from 1938 to 1939. Keen to know as much as possible about Jewish history, I met her with great pleasure. After that meeting

with Prof. Epstein a strong friendship grew between us. She seemed to love Albania and the Albanians very much. Humbly she 'took me by the hand' in a confessional journey of a life that could truly impress anyone who has human feelings and desires to know and learn. She has had a long academic and research career as an economist and anthropologist, author of 14 books, numerous articles and documentary films.

She was honoured with many awards and titles including the OBE (Order of the British Empire) awarded in 2004. My last meeting with her in February 2014 at Brighton Nursing Home remains for me unforgettable.

'Swimming against the Stream'

One day she gave me as a gift her book that she had published about her life, 'Swimming against the Stream'. This book is on my personal bookshelf and holds a handwritten dedication from the author: She had signed it with 'A small sign of great admiration. Scarlett'. Her confession in that book is breathtaking on almost every page of it. I thought that based on that sincere and dramatic confession of Professor Epstein I would make known her story that relates to us Albanians, on this very day when she passed away. This book that was published in English in 2005 in London contains the story of a difficult life and conveys a strong message: 'I'm alive thanks to Albanian generosity!'.

Prof. T. Scarlett Epstein lived to be 92 years of age. Grey haired, timid, with a small body she resided in the coastal city of Brighton, UK. She was always present with us whenever we had activities in the Albanian Embassy in London.

Wherever there was a talk on Albania she was always there, telling the story of the Jews and the Holocaust and the protection that Albanians had given them in the most difficult days of their history. You could find her everywhere, in schools, universities, libraries, film festivals and at every important international meeting and in synagogues. She went to Washington DC in New York, to the University of Vienna, to the European Parliament in Brussels, to Cambridge, to Oxford and to Tirana also to meet the Albanians.

Everywhere she conveyed the same message: 'I am alive thanks to Albanian generosity!'. Her story is a very painful one like so many stories of the Jews but with a happy ending. It is similar to the stories of the nearly three thousand Jews who escaped to Albania.

Anschluss – Vienna – Zagreb

Prof. T. Scarlett Epstein was born in July 1922, and her name was Trude Grünwald. She and her parents and brothers were targeted by the Nazis at the time known as the Anschluss or the annexation of Austria by Nazi Germany on March 12, 1938. The persecutions against them were similar to those applied to Jews in Germany. Like many other families the Epstein family, now with their names changed, had to leave Vienna for a safer place. The young 16-year-old girl who was attending high school and full of dreams about her future faced the alternative of life or death. So, she took control not only of her own destiny but also of her parents. She managed to secure entry visas to Yugoslavia and with the help of her uncle who was a wealthy industrialist they settled in Zagreb. But, after three months their visas expired and they had to leave Yugoslavia or be forcibly deported to their country of origin. The only way out was to secure a visa for a country outside the influence of the Germans. This country turned out to be Albania.

King Zog and the Jews

The young girl knocked on the doors of many consulates in Zagreb at the time but they all quickly closed in front of her eyes as soon as she showed to those officials her passport with the letter 'J' stamped on it by the Nazis. Under these circumstances her uncle tells her that there is just one way to escape and that was to go to Albania. Another Jew who traded with Albania had told her uncle that Albania had a trade agency in Zagreb which also carried out consular actions and that they welcomed and treated the Jews generously.

According to her uncle Albania was celebrating the anniversary of its kingdom and King Zog had ordered the state officials to give visas to all tourists, even to Jews. All she knew from geography and history lessons about Albania was that

it was a country that lay on the Adriatic coastline and bordered Yugoslavia and Greece. Now the Jewish family had three options: to hide across Yugoslavia and wait for the bad luck of their deportation to Austria; to return to Austria by their own will and end up in a Nazi concentration camp or go to an unknown place, like Albania. She managed to persuade her parents and knocked on the doors of that Albanian office just three days before the visa expired.

The Albanian consul met her with respect and despite the fact that she told him they were Jewish hiding from the Germans and that they had passports with the letter "J", he provided them with visas. They immediately made their way to Split from where they boarded a ship that would land them in Durres. At the start they were followed by many Jews who were trapped in Nazi horror. With some of those people who left Split that day and went somewhere else and not to Albania, she would never be seen again, as they did not survive Nazi terror.

Durres: November 20th 1938

On this date they arrived in Albania, took refuge there and lived in the city. They were escorted to the Metropol Hotel near the port. Her description of the state of this hotel leaves no room for pleasure but the welcome that this family in complete despair received from the Albanians makes everyone feel proud. She describes Durres at that time as a city of mixed Muslim and Orthodox populations living in peace.

After a few weeks of staying at the Metropol Hotel this family were offered the opportunity to stay in a type of compound that was given to them by the City Council. There were Jews there of different nationalities whom Nazi horror had united in their fate. This housing complex was funded by the American International Jewish Relief Committee with the consent of the Government of the Kingdom of Albania.

Her life in Durres: November 1938 – April 20th 1939

The need to survive taught her more than anything else in life because the value of life doubles when it becomes uncertain. So, Scarlett Epstein started to look for work and found students who wanted to learn German. Among them were

two girls. They were the daughters of the Dovana family, one of the most popular families in Durres. With this family she created a strong bond of friendship that continued to the day that she died. Under Albanian law refugees were not allowed to work.

However, thanks to her immediate friendship with the Albanians she managed to become a teacher even though she was still young. Her family was treated with special love not only by the ordinary inhabitants of the city but also by the mayor of Durres.

The episodes of Scarlett Epstein's life in Durres are all so picturesque and interesting. What remained in her memory she often confessed to her audiences, in private conversations or even in her book where she spoke of the love she experienced in that city and how grateful she was for it. 'Albania saved my life', this was the subject of her every story. However, this could not be a country where Jews could live, not being allowed to work, as they are so passionate about trade and other professions.

With two brothers in Britain, Oton and Kurt, she decided to try to reunite her family over there in the UK. She managed to secure visas for herself and her mother but not for her father. Their visas would expire on April 30, 1939. Meanwhile, what Epstein was experiencing she described as an eyewitness is the following:

She witnesses the Italian fascist occupation of Albania on April 7th 1939

Epstein points out in her book that the morning of that Good Friday, April the 7th 1939, came in Durres with boats beginning to appear one after another, lots of them, on the city's shores. Residents of the city centre where the Jewish refugees were housed were instructed to leave and go to the rural areas as their centre was next to the police station which had two machine guns.

The police station would be the main objective for the Italians to capture. That could seriously harm the residents of the centre. There were only a few Albanian Army soldiers in the town. The Jews decided to go to the cellar of a house near the City Council. The fighting and the shooting continued. The Jews

were waiting to see what would happen to them and how the Italians would behave towards them.

Scarlett did not know if the Italians were as anti-Semitic as the Germans were. The Jews decided to leave, taking only the easiest things with them. They went through a field where bullets flew above their heads. They wanted to be sheltered in a house where they could be safe. The exchange of fire between the Italian and Albanian forces took several hours. She testifies that she saw people killed and left on the street.

Now it was to happen that the Italian invaders, the friend of the enemy, became the friend of the Jews. After a few hours the Jewish group confronted the Italians. With the gun bayonets open they were instructed to stop. At the front of the crowd was Scarlett, not because of her courage but because of being the only one who could speak Italian. She told the Italians that they were Germans.

The Italians immediately responded kindly to them, saying,"The Germans and Italians are friends." They did not take note of the fact that as Jews they were Hitler's biggest enemies and that he was chasing them everywhere to kill them. She explained to the Italian commander that they had left their home because of their fear of any Italian attack but now they wanted to return there again.

The Italian commander assured them that since they were Germans they were considered friends and would be guaranteed protection by the honouring of relations between the two countries. So, though it sounds like a joke, they were put under Italian protection and returned home, without really thinking of under whose protection they were in this situation.

With this promise they did not understand if the Italians were there to protect or punish them. With a touch of humour she tells us that the allies of Hitler, the greatest enemy of the Jews, became their protectors. The invasion was completed the next day which was Good Friday and the Italians headed for Tirana.

The Jews remained in Durres while Scarlett received a letter from the mayor of Durres, the former Italian consul who had already become mayor of the city. He

asked her to continue teaching him the German language as she had done before. He promised that as long as he was in that position nothing would happen to them from the Italian army. Years later she became interested in learning about the fate of Luigi Alois, the consul who by his work had defied, not without risk, Italian fascism.

Leaving Albania

When the course of events took a different direction Scarlett Epstein had no choice but to use the English visa provided by her brothers. So, on April 20, 1939 she and her mother set out on a dangerous journey to Italy by boat and then by plane to Berlin, Cologne, Amsterdam and London. The further years of this lady's life are full of events but stories of suffering and danger were engraved in her memory. She memorized the past and moved on to travel the paths of life prepared to meet the unexpected on her way. She began her life in England as an emigrant making great personal sacrifices, sewing uniforms for English soldiers of World War II.

But, after a while with great strength and will she did manage to pursue her undergraduate studies. She pursued a doctorate degree and became a professor and one of the best-known anthropologists in the UK.

The friendship with Professor Scarlett Epstein

With Prof. Epstein I had a strong sincere friendship based on her beautiful feelings of gratitude, hospitality and Albanian *Besa* (word of honour). She had two daughters, Debby and Michelle. In fact she had three. The third one is an Albanian lady, a former Minister, the adviser to the Albanian Embassy in London. She was a respected lecturer and an excellent diplomat, Dr Teuta Starova. She had become her third daughter. She spent days and nights attending talks, going to universities, synagogues and schools to talk about Albania and the Albanians. She had long phone conversations making plans on how to let the world know about the Albanian value of *Besa* and hospitality. In 2012 at the Wiener Holocaust Library in London a meeting was organized dedicated to Prof. Scarlett Epstein in the presence of the Jewish and Albanian

community of London. Israeli Ambassador to Great Britain Daniel Taub attended this event. There Prof. Scarlett Epstein was honoured with the Symbol of the City of Tirana. Also in attendance was Mrs. Ingrid Strati, a well-known Albanian intellectual from Durres staying in Italy, a descendant of the distinguished patriotic Dovan family.

With that family Scarlett had re-established contacts only recently with the help of another Albanian Embassy diplomat, Mrs. Joanna Papacostandini. Joanna was not only from Durres but also her family were very close friends with the Dovana family. It seemed that even after 74 years that great hospitality of Dovanajave had not been forgotten by Epstein and that the gratitude to them and to Dürres had not been extinguished.

So, in the Spring of 2012 she travelled to Dürres, to revisit her old paths where old memories flashed and she went on to shoot a documentary on her history in that city. In 2012 Scarlett Epstein travelled to Washington DC to participate in commemorating Albanian efforts to protect Jews during the Holocaust.

Then having been invited by Vatra we celebrated with her the 100th Anniversary of Albanian Independence. The initial invitation was from the Albanians of New York. In 2014, after a series of activities on Albania, she gave a long speech at the European

Parliament on Albanian *Besa* which was received with great admiration.

Epilogue

The respect for this lady is endless and flows from memories of shared struggles and hardships that drew on her strength and generosity. Above all the eternal gratefulness that she had towards the Albanians remains close to my heart.

In fact Albanians have done for this lady what they do for every human who knocks on their door but she has rewarded them with so much work to make their hospitality known everywhere, wherever Albanians need recognition, support and warmth.

We visited her shortly before her death. The meetings and conversations with her were not only of particular pleasure but also of a moral obligation to a historical connection between Albanians and Jews whose two countries have secured freedom with so much suffering, pain and struggle. Prof. T. Scarlett Epstein has just passed away and will be buried on April 29th 2014 at the Jewish Cemetery in Hove, East Sussex, Brighton.

She left behind a story that must not be forgotten. This is a tribute to everything that Albania did for her and what she did for Albania.

Rest in peace!

Mal Berisha

London, April 27, 2014

1830 – BENJAMIN DISRAELI – DY HERË KRYEMINISTËR I BRITANISË SË MADHE VIZITON SHQIPËRINË

1830 – BENJAMIN DISRAELI – Dy herë Kryeministër i Britanisë së Madhe viziton Shqipërinë

NGA MAL BERISHA

Midis gjithë udhëtarëve që kanë udhëtuar nëpër Shqipëri, njëri prej tyre është ndoshta më interesanti për nga rëndësia. Ai ishte Benjamin Dizraeli, dy herë

kryeministër i Britanisë së Madhe gjatë epokës së Mbretëreshës Viktoria. Siç kishte edhe emrin, ai njihet si benjamini i kësaj të fundit. Herën e parë ai qeverisi vetëm për 9 muaj, nga shkurti deri në dhjetor të vitit 1868, ndërsa herën e dytë për 6 vjet, nga shkurti 1874 deri në prill 1880.

Në vitin 1830, ai ndërmori një udhëtim, i cili zgjati 17 muaj nga Malta deri në Shqipëri. Në letrën e parë që i shkruan të atit i drejtohet me këto fjalë:

"I dashur baba.

...Të përmenda në letrën time se ka mundësi që të bëj një vizitë tek Veziri i Madh në Janinë, në kryeqytetin e Shqipërisë".

Të jetë vizituar Shqipëria e atëherëshme nga një kryeministër i ardhshëm britanik, sigurisht që sot mund të shihet si një ngjarje e madhe e asaj kohe, pavarësisht se në kohën e udhëtimit ai ishte thjesht një djalë që kërkonte aventura në vende ekzotike, larg Londrës së tij të zhurmshme. Benjamin Dizraeli vizitoi Artën dhe Janinën, këtë të fundit duke e cilësuar edhe kryeqyteti i Shqipërisë. Letrat e tij, dërguar babait janë të mbushura me plot informacion për Shqipërinë e asaj kohe. Në fakt është interesant të shënohet se të gjithë udhëtarët britanikë që kanë kaluar në viset jugore të Shqipërisë deri në Janinë e Prevezë dhe Artë i referohen vendit tonë si Shqipëria dhe jo si një Provincë Osmane. Por ajo që citon Dizraeli është shumë më e rëndësishme dhe një referencë historiografike me vlerë. Dizraeli ishte Kryeministri britanik në kohën e Kongresit të Berlinit, një ngjarje pasojat e së cilës dihen mirë.

Si një intelektual i klasit të parë, Disraeli ka shkruar njëzet e tre libra. Ka shumë biografë, të cilët janë marrë me jetën dhe veprimtarinë e tij. Ndër ta është Dauglas Hurd, Sekretari i Jashtëm britanik nga viti 1989 deri në vitin 1995.[1]

Robert Blake e ka trajtuar atë gjerësisht.[2] Në librin e tij Blake na jep një pamje të pakëndshme të këtij britaniku të madh me gjak hebre, i prirur për të qenë palë me pushtuesit dhe jo me të pushtuarit. Si njeri që do të merrte frenat e një shteti perandorak, ai në një moment të caktuar kërkon të renditet në radhët e forcave turke për të luftuar kundër shqiptarëve kryengritës ndaj Perandorisë Osmane, në fillimin e viteve 1830. Në të njëjtën mënyrë ai shprehu antipati ndaj grekëve,

të cilët kërkonin shkëputjen nga osmanët. Tek ai mbizotëronte më shumë pikpamja e tij perandorake se sa ajo e krishterë, ndonëse vetë ai ishte një hebre i konvertuar i krishterë që në moshën shtatëmbëdhjetë vjeçare.

Si një nga figurat qendrore të politikës britanike të shekullit të nëntëmbëdhjetë, është interesant të shihet se me çfarë syri i ka vështruar ai shqiptarët. Po ashtu është me mjaft interes të shohësh që dy vjet pas kthimit nga udhëtimi në Shqipëri ai shkroi një vepër për Skënderbeun të titulluar "*The rise of Iskander*".[3]

Kjo është një vepër letrare që ka në qendër Skënderbeun, por megjithatë ai nuk i jep identitetin e duhur atij, ndërsa ngjarjen e vendos në Athinë dhe në Hungari. Disraeli është njeriu që polemizoi më fort në parlamentin britanik dhe ka po ashtu numrin më të madh të thënieve të cituara në historinë e politikës britanike. Një ndër thëniet e tij më cinike ndaj rivalit të jetës së tij Gladstone, po ashtu kryeministër i alternuar i laburistëve, ishte ndryshimi i inicialeve: GOM që do të thoshte, *Grand Old Man*, – Plaku i Madh në *"God's Only Mistake"*, ose i Vetmi Gabim i Zotit. Kjo fjalë ka mbetur si shenjë kulmore e debatit politik midis kryeministrit me atë të liderit të opozitës, në parlamentin britanik.

Në turin e tij në Shqipërinë e Jugut Dizraeli shoqërohet nga shqiptarët që e mbrojnë atë. Ai i përshkruan ata si më poshtë:

"Tërë këta shqiptarë janë të armatosur deri në dhëmbë, me kama, pistoleta dhe pushkë krejt të mbuluara me zbukurime të pasura, dhe nganjëherë tërësisht të lara në argjend deri tek qyta".

Duhet pranuar se për shkak të mentalitetit të politikës perandorake Viktoriane, madje edhe një benjamin i saj, pra pikërisht ky politikan britanik, mund të kishte në dorë të ndihmonte Shqipërinë në Kongresin e Berlinit, por nuk tregoi ndonjë dëshirë për ta bërë këtë. Ai pranoi të linte në fuqi Traktatin e Shën Stefanit, i cili kishte shkëputur nga trungu shqiptar pjesë të rëndësishme të territorit shqiptar. Arsyet?

Letra që shqiptarët i dërguan Benjamin Dizraelit, që është pjesë e këtij libri, mund të merret si një shembull konkret për këtë. Megjithatë, duhet thënë se pa

kontributin e tij, lakmitë e fqinjëve për copëtim edhe më të madh të trojeve shqiptare, mund të kishin shkaktuar në humbje edhe më të mëdha të territoreve tona, se sa ato që kanë ndodhur.

---

[1] Me këtë autor kam patur rastin të bisedoj për librin e tij që sapo e kisha lexuar si dhe për Dizraelin dhe Shqipërinë. Dauglas Hurd ka luajtur një rol të rëndësishëm në rivendosjen e marrëdhënieve diplomatike Shqipëri – Mbretëri e Bashkuar. Në një rast tjetër, gjatë takimit të Ministres tonë të Integrimit me z. David Lidington, Ministër i Zgjerimit Europian në Foreign Office, patëm rastin të flisnim për Dizraelin. Ai mbante në zyrën e tij portretin e Benjamin Dizraelit. Kur mbaruam takimin e pyeta:

– A është Dizraeli idhulli juaj politik?

– Po, më tha, – është, dhe shtoi: Nuk ka politikan më të sofistikuar se ai.

Kjo na dha mundësinë të hapnim një bisedë të gjatë për lidhjet e Disraelit me Shqipërinë.

[2] Robert Blake, Dizraeli, faqe 60, 64-65, 579.

[3] Rise of Iskander – Benjamin Disraeli – University of Adelajde – botuar për herë të parë në vitin 1834.


Benjamin Disraeli
Naltësimi i Iskanderit
Këtë studim i plotë dha vepra e përkthyer nga
Mal Berisha
KOHA